



Procedurat e vetingut që çuan në shkarkimin nga detyra të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese ishin të rregullta dhe shkarkimi ishte proporcional

Në vendimin¹ e sotëm të trupës gjyqësore të Dhomës në çështjen [Xhoxhaj k. Shqipërisë](#) (çështja nr. 15227/19) Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi:

me shumicë votash (6 kundër 1) se **nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut përsa i përket pretendimit për mungesë të pavarësisë dhe paanshmërisë të organeve të vetingut,

me shumicë votash (5 kundër 2) se **nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1** përsa i përket pretendimit për parregullsi të procedurave,

me shumicë votash (5 kundër 2) se **nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1** përsa i përket pretendimit për mosmbajtjen e një seance publike përpara Kolegjit të Apelit,

me shumicë votash (5 kundër 2) se **nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1** përsa i përket pretendimit për shkelje të parimit të sigurisë juridike, dhe

me shumicë votash (5 kundër 2) se **nuk kishte shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)**.

Çështja shqyrtoi shkarkimin nga detyra të një gjyqtare të Gjykatës Kushtetuese në vijim të procedurave të filluara ndaj saj, si pjesë e një procesi të jashtëzakonshëm për rivlerësimin e përshtatshmërisë në detyrë të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend, i njohur ndryshe si procesi i vetingut. Çështja e kërkuësës u shqyrtua nga organet e vetingut, dhe Kolegji i Apelit, pasi e mori çështjen në shqyrtim në dhomë këshillimi, la në fuqi shkarkimin e saj nga detyra.

Gjykata arriti në përfundimin se **nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1**, pasi organet e vetingut kishin qenë të pavarura dhe të paanshme, procedurat kishin qenë të rregullta, shqyrtimi i ankimit të kërkuësës në seancë publike nga Kolegji i Apelit nuk kishte qenë i domosdoshëm dhe nuk ishte shkelur parimi i sigurisë juridike.

Për më tepër, Gjykata konstatoi se **nuk kishte shkelje të nenit 8**, pasi shkarkimi nga detyra kishte qenë proporcional dhe ndalimi i përhershëm ligjor për të rihyrë në sistemin e drejtësisë për shkak të shkeljeve të rënda disiplinore kishte qenë në përputhje me garantimin e integritetit të detyrës së magistratit dhe të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Faktet kryesore

Kërkuësja, Altina Xhoxhaj, është shtetase shqiptare e cila ka lindur më 1970 dhe jeton në Nju Jork (Shtetet e Bashkuara të Amerikës).

Konteksti

1. Sipas nenit 43 dhe 44 të Konventës, ky vendim i trupës gjyqësore të Dhomës nuk është përfundimtar. Gjatë periudhës tremujore pas shpalljes së tij, secila palë mund të kërkojë që çështja të shqyrtohet nga trupa e Dhomës së Madhe të Gjykatës. Kur bëhet një kërkesë e tillë, një panel prej pesë gjyqtarësh do të vendosë nëse çështja duhet të shqyrtohet më tej. Në atë rast, Dhoma e Madhe do të shqyrtojë çështjen dhe do të nxjerrë një vendim përfundimtar. Nëse kërkesa nuk pranohet, vendimi i dhënë nga trupa gjyqësore e Dhomës do të bëhet përfundimtar atë ditë.

Pasi vendimi bëhet përfundimtar, ai i përcillet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për mbikqyrje të ekzekutimit të tij. Ju mund të gjeni informacion të mëtejshëm për procesin e ekzekutimit në këtë faqe të internetit: www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution.

Për vite me rradhë anketimet e zhvilluara në Shqipëri tregonin një shqetësim të madh të publikut në lidhje me nivelin e korrupsionit të perceptuar në sistemin e drejtësisë. Ndër të tjera, publiku besonte se bëheshin pagesa korruptive për emërimet në vende pune, prokurorët pranonin ryshfet për të pushuar çështje dhe gjyqtarët kryenin mitmarrje për të zvarritur seanca gjyqësore ose favorizuar palë të ndryshme.

Si pasojë, më 2016 parlamenti shqiptar ndryshoi Kushtetutën dhe miratoi Ligjin për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (i njohur si Ligji i Vetingut) për të mundësuar zhvillimin e reformës (në sistemin e drejtësisë). Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët do t'i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit që do të zhvillohej nga dy organe të sapokrijuara: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) në shkallë të parë dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit në shkallë apeli. Prosesi i rivlerësimit do të kryhej mbi bazën e tre kriterëve: vlerësimi i pasurisë në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të familjes së tij, kontrolli i figurës për të zbuluar lidhje të mundshme me krimin e organizuar dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

Komisioni i Venecias dha mendime për ndryshimet kushtetuese si dhe për Ligjin e Vetingut, duke u shprehur se vetingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve ishte i justifikuar dhe i nevojshëm « për të mbrojtur Shqipërinë nga sëmundja e korrupsionit, i cili, po të mos luftohet, mund të shkatërrojë tërësisht sistemin gjyqësor ». Edhe Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë u shpreh në favor të kushtetueshmërisë të Ligjit të Vetingut.

Rasti i Znj. Xhoxhaj

Kërkuesja u emërua si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit të Tiranës më 1995 dhe më pas u zgjodh si anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Më 2010 ajo u zgjodh gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese për një mandat nëntëvjeçar. Duke filluar nga viti 2003, ajo dhe bashkëjetuesi i saj, i cili ishte nëpunës publik, deklarorin pasuritë çdo vit. Më 2016, në zbatim të Ligjit të Vetingut, ajo dorëzoi tre deklarata të ndryshme, më konkretisht një deklaratë të pasurisë, një deklaratë për kontrollin e figurës dhe një formular të vetëvlerësimit profesional. Në deklaratën e pasurisë, kërkuesja deklaroi, ndër të tjera, se ishte bashkëpronare e një apartamenti prej 101 m² dhe kishte disa llogari të huaja bankare në emër të vet.

Në nëntor 2017 u krijua trupa gjyqësore e KPK-së e cila filloi hetimin mbi deklaratat e kërkueses për shkak se ajo ishte gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese. Në mars 2018 KPK-ja njoftoi kërkuesen për gjetjet paraprake, duke vënë në dukje mospërputhje për disa pasuri të saj si dhe një gjendje të likuiditeteve të pajustificuara gjatë disa viteve. Gjithashtu, një shtetas kishte bërë një denoncim për konflikt interesi në lidhje me kërkuesen dhe babanë e saj, si pasojë e të cilit ajo nuk ishte tërhequr nga shqyrtimi i një ankese kushtetuese të depozituar nga ai shtetas. Sipas ligjit, kërkuesja kishte barrën e provës për të justifikuar ligjshmërinë e pasurive të saj dhe ajo duhej të paraqiste sqarime në lidhje me këto mospërputhje. Në përgjigje, kërkuesja paraqiti një mori shpjegimesh me shkrim dhe argumente me gojë gjatë një seance publike.

KPK-ja e shpalli vendimin më 4 qershor 2018 dhe arriti në përfundimin që kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj nuk kishin provuar se kishin patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të blerë apartamentin prej 101 m². Gjithashtu, ajo nuk kishte deklaruar me vërtetësi burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie dhe nuk e kishte deklaruar atë për disa vite në deklaratat vjetore të pasurisë. Përveç kësaj, kishte patur mungesë dokumentacioni mbështetës ligjor që të justifikonte ligjshmërinë e burimit të të ardhurave. KPK-ja arriti gjithashtu në përfundimin, ndër të tjera, se kërkuesja nuk kishte deklaruar konfliktin e interesave dhe nuk ishte tërhequr nga shqyrtimi i gjykimit kushtetues për të cilin një shtetas kishte bërë denoncim. Për shkak të këtyre shkeljeve, KPK-ja vendosi shkarkimin nga detyra të kërkueses.

Kërkuesja ushtroi ankim pranë Kolegjit të Apelit, duke paraqitur një mori argumentesh, sidomos me pretendimin se shkarkimi nga detyra nuk kishte qenë proporcional dhe se procedura e vetingut

kishte qenë, ndër të tjera, e parregullt, e pabarabartë dhe në kundërshtim me ligjin. Kolegji i Apelit, i cili e shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi, nxorri përfundime të shumta në lidhje me procedurën e rivlerësimit përpara organeve të vetingut si dhe për kriteret e rivlerësimit. Përsa i takon vlerësimit të pasurive, ai prishi disa nga përfundimet e KPK-së për disa pasuri, por la në fuqi përfundimin se kërkesja dhe bashkëjetuesi i saj nuk kishin patur të ardhura të mjaftueshme për të blerë apartamentin prej 101 m² dhe se ajo kishte bërë një deklaram të rremë dhe kishte fshehur atë pasuri për disa vite. Përsa i përket vlerës së likuiditeteve të pajustificuara për disa vite, Kolegji i Apelit u shpreh se kërkesja « nuk shpjegon bindshëm burimin e ligjshëm të këtyre shumave monetare, përpiqet të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në likuiditete, si dhe ajo vetë dhe personi i lidhur me të nuk kanë justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave për këto shuma monetare ». Për më tepër, Kolegji i Apelit konstatoi se bashkëjetuesi i saj nuk kishte deklaruar një shumë parash që e mbante në gjendje « cash » gjatë disa viteve, në kundërshtim me ligjin, dhe se kërkesja nuk kishte deklaruar llogaritë e huaja bankare në deklaratat vjetore të pasurive. Së fundi, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, mostërheqja e kërkeses nga gjykimi kushtetues kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Kolegji i Apelit la në fuqi vendimin për shkarkimin nga detyra të kërkeses, i cili u bë përfundimtar.

Ankesat, procedura dhe përbërja e Gjykatës

Kërkesja u ankua, duke u bazuar në nenin 6 të Konventës, se organet e vetingut nuk ishin të pavarura dhe të paanshme, pasi anëtarët e tyre nuk kishin profesionalizmin dhe përvojën e duhur, ishin emëruar pa përfshirjen e pushtetit gjyqësor dhe organet e vetingut kishin ngritur « akuzën » dhe vendosur njëkohësisht mbi thelbin e « akuzës ». Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 6 të Konventës, ajo u ankua se procedurat në rastin e saj kishin qenë të parregullta për disa arsye.

Për më tepër, duke u bazuar në nenin 8, kërkesja u ankua se shkarkimi i saj nga detyra kishte qenë arbitrar.

Kërkesa u regjistrua pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut më 8 mars 2019.

Vendimi u dha nga një Dhomë e përbërë prej shtatë gjyqtarësh, sikurse tregohet më poshtë:

Paul Lemmens (Belgjika), *President*
 Georgios A. Serghides (Qipro),
 Dmitry Dedov (Rusia),
 Georges Ravarani (Luksemburgu),
 Maria Elósegui (Spanja),
 Darian Pavli (Shqipëria),
 Peeter Roosma (Estonia)

si dhe Milan Blaško, *Kancelari i Seksionit*.

Vendimi i Gjykatës

Neni 6 § 1

Komisioni Evropian, në emër të Bashkimit Evropian, dorëzoi parashtrime si palë e tretë në çështje.

1. Pajtueshmëria me parimin « nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj »

Pasi arriti fillimisht në përfundimin se neni 6 zbatohet vetëm në aspektin civil të tij, Gjykata çmoi se organet e vetingut ishin ngritur dhe formuar në mënyrë të ligjshme dhe kishin qenë « gjykatë e krijuar me ligj », për shkak të bazës ligjore mjaftueshmërisht të qartë (duke iu referuar Kushtetutës dhe Ligjit të Vetingut) e cila parashikonte ngritjen e KPK-së dhe të Kolegjit të Apelit, për shkak të juridiksionit dhe kompetencave të tyre ekskluzive për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve,

prokurorëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë si dhe të mënyrës së formimit të tyre në çështjen e kërkujes.

Gjykata nuk e gjeti të bazuar pretendimin për mungesë të pavarësisë së KPK-së dhe Kolegjit të Apelit. Ajo nuk pati dyshime për mënyrën e zgjedhjes të anëtarëve të organeve të vetingut, pasi zgjedhja e tyre kishte qenë në përputhje me procedurën ligjore. Dokumentet në dosje treguan se, pas emërimit të tyre, ato nuk i ishin nënshtruar ndonjë presioni nga pushteti ekzekutiv gjatë shqyrtimit të rastit të kërkujes. Mospërzgjedhja e anëtarëve të organeve të vetingut nga trupa e gjyqtarëve aktualë ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të vetingut, në veçanti në përprjekje për të shmangur ndonjë konflikt të interesit dhe për të garantuar besimin e publikut në këtë proces. Kohëzgjatja e mandatit të tyre ishte e pranueshme duke patur parasysh natyrën e jashtëzakonshme të procesit të vetingut. Gjykata arriti në përfundimin që legjislacioni i brendshëm kishte parashikuar garanci ndaj palëvizshmërisë së tyre si dhe për funksionimin e duhur të organeve të vetingut.

Përsa i përket paanshmërisë, Gjykata vuri re se nuk kishte detyrim të roleve të KPK-së: detyrimi ligjor për të filluar hetimin ishte automatik dhe nuk kushtëzohej nga ngritja e ndonjë « akuze » për shkelje disiplinore ndaj kërkujes; gjetjet paraprake të tij ishin bazuar mbi informacionin që ndodhej në dosje kur ende nuk ishin marrë parasysh argumentet mbrojtëse të kërkujes; dhe ai e kishte marrë vendimin mbi përgjegjësinë disiplinore të kërkujes mbi bazën e të gjitha parashtrimeve që ishin bërë, duke përfshirë provat që kishte paraqitur dhe argumentet që ajo kishte ngritur në seancë publike. Sipas Gjykatës, fakti që KPK-ja kishte bërë gjetjet paraprake në rastin e kërkujes nuk përbënte dyshim të justifikuar në mënyrë objektive për anshmërinë e tij. Përsa i përket Kolegjit të Apelit, Gjykata çmoi se kërkuësja nuk kishte paraqitur ndonjë argument thelbësor. Gjykata vlerësoi që Kolegji i Apelit kishte patur juridiksion të plotë për shqyrtimin e shkaqeve të ankimit të kërkujes dhe kishte dhënë një vendim të detajuar në rastin e saj.

Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte patur shkelje të nenit 6 § 1 përsa i takonte pretendimit për mungesën e pavarësisë dhe paanshmërisë të organeve të vetingut.

2. Pajtueshmëria me detyrimin për një proces të rregullt

Gjykata përsëriti se nuk ishte detyra e saj të zëvendësonte gjykatat e brendshme. U takonte kryesisht autoriteteve të brendshme, sidomos gjykatave, të zgjidhnin probleme të interpretimit të të drejtës vendase dhe të vlerësimit të provave.

Së pari, Gjykata vuri re se fillimi i hetimit nga KPK-ja kishte qenë në përputhje me ligjin. Në përfundim të tij, gjetjet paraprake i ishin bërë me dije kërkujes. Sipas Gjykatës, gjetjet e hetimit duhet t'i kishin mundësuar kërkujes të kuptonte peshën e atyre gjetjeve paraprake dhe të përgatiste mbrojtjen e saj. Kërkuësja, e cila ishte e përfaqësuar nga një avokate e zgjedhur prej saj, kishte paraqitur një mori argumentesh dhe parashtrimesh. Nuk kishte ndonjë tregues se ajo nuk kishte patur kohë dhe mundësi për të përgatitur një mbrojtje të kënaqshme.

Gjykata vlerësoi se pretendimi i kërkujes se KPK-ja kishte fshehur disa prova ishte « vetëm një hamendësim » i pambështetur mbi ndonjë provë në dosje. KPK-ja kishte patur juridiksion të plotë mbi të gjitha çështjet faktike dhe ligjore dhe kishte marrë vendim duke dhënë arsye të mjaftueshme në përgjigje të argumenteve kryesore të kërkujes.

Së fundi, Gjykata vendosi se Kolegji i Apelit kishte ushtruar juridiksion të plotë në procedurat e zhvilluara përpara tij, në përputhje me ligjin, dhe kishte shqyrtuar çdo shkak të ankimit të kërkujes, përfshirë edhe refuzimin për të pranuar prova të reja, duke dhënë arsye të mjaftueshme për vendimin e tij.

Si rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte patur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me pretendimin për parregullsinë e procedurave.

3. Pajtueshmëria me detyrimin për të mbajtur një seancë publike përpara Kolegjit të Apelimit

Gjykata përsëriti se, sipas jurisprudencës së saj, ajo kishte thënë se e drejta për një seancë publike nënkuptonte të drejtën për një seancë dëgjimore përpara të paktën një shkalle gjykimi. Për më tepër, Gjykata u shpreh se, vetëm në raste përjashtimore, procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve mund të zhvilloheshin pa asnjë seancë dëgjimore.

Gjykata konstatoi se përpara KPK-së, i cili ishte i pavarur dhe i paanshëm, ishte zhvilluar një seancë publike dhe se kërkesja nuk kishte kërkuar një seancë dëgjimore përpara Kolegjit të Apelimit, i cili, gjithsesi, kishte dhënë arsye të mjaftueshme për mosmbajtjen e një seancë publike. Për shkak të natyrës së procedurave në apel, gjatë të cilave kërkesja kishte patur mundësi të plotë të paraqiste argumentet e saj me shkrim, dhe faktin se nuk kishte qenë e nevojshme të pyetej ndonjë dëshmitar ose të merrej ndonjë provë tjetër gojarisht, mbajtja e një seance publike nuk kishte qenë e domosdoshme.

Si rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte patur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me pretendimin për mungesë të një seance publike përpara Kolegjit të Apelimit.

4. Respektimi i parimit të sigurisë juridike

Gjykata theksoi se afatet e parashkrimit janë të rëndësishme për respektimin e sigurisë juridike. Megjithatë, Gjykata shtoi se kontrolli i pasurive, duke qenë një masë në luftën kundër korrupsionit, paraqiste tipare të veçanta, pasi pasuritë normalisht akumulohen gjatë gjithë jetës dhe autoritetet e brendshme kishin detyrimin të vlerësonin ligjshmërinë e të gjitha pasurive të fituara nga subjektet e vlerësimit.

Gjykata vuri re se përfundimet e pafavorshme ndaj kërkuësës kishin të bënin me deklaratimet që ajo kishte bërë në deklaratën e pasurisë të vetingut dhe në deklaratat e pasurisë të viteve të mëparshme. Fakti që kërkesja ishte vendosur në një pozicion disi të vështirë për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve fillestare financiare, të cilat kishin shërbyer si bazë për blerjen e apartamentit prej 101 m², ishte shkaktuar pjesërisht nga mosdeklarimi i asaj pasurie nga kërkesja në kohën kur ajo e kishte blerë atë pasuri. Përveç kësaj, kërkesja nuk kishte dorëzuar asnjë provë që të justifikonte ekzistencën e një pamundësie objektive për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve financiare, e cila ishte një rrethanë lehtësuese e parashikuar në Ligjin e Vetëingut. Për më tepër, fakti që barra e provës i kishte kaluar kërkuësës pas gjetjeve paraprake në procedurat e vetingut nuk ishte në vetvete arbitrare.

Si rrjedhojë, Gjykata vendosi se nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me pretendimin e shkeljes të parimit të sigurisë juridike.

Neni 8

Gjykata u shpreh se shkarkimi nga detyra përbënte një ndërhyrje me të drejtën e kërkuësës për respektimin e jetës private, ndërhyrje e cila kishte qenë në përputhje me të drejtën e brendshme dhe në interes të qëllimeve legjitime sipas Konventës. Shkarkimi nga detyra ishte mbase masa disiplinore më e rëndë që mund të jepej ndaj një personi, e cila kërkonte prova shumë bindëse të shkeljeve etike dhe profesionale. Në vlerësimin e domosdoshmërisë për marrjen e kësaj mase, Gjykata mori parasysh « nevojën e domosdoshme shoqërore » në Shqipëri për të reformuar sistemin e drejtësisë për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit në gjyqësor.

Për të vlerësuar nëse arsyet e dhëna nga organet e vetingut kishin qenë « të përshtatshme dhe të mjaftueshme », Gjykata shqyrtoi shkaqet që kishin çuar në shkarkimin nga detyra të kërkuësës, në veçanti vlerësimin e pasurive dhe të aftësive profesionale.

Përsa i përket vlerësimit të pasurive, ajo vuri re se kërkuësës i ishte kërkuar të justifikonte të ardhurat e ligjshme fillestare që kishin shërbyer për blerjen e pasurive të saj. Gjykata nuk identifikoi ndonjë përfundim arbitrar ose qartazi të paarsyeshëm në vendimet e brendshme që kishin vendosur

se kërkuesja kishte qenë palë kontraktore në blerjen e apartamentit prej 101 m² dhe se ajo nuk e kishte deklaruar atë pasuri për disa vite. Gjykata iu referua parimeve ndërkombëtare të cilat kërkojnë që gjyqtarët t'u përmbahen standardeve të larta të integritetit edhe në administrimin e interesave të tyre private jashtë detyrës – përtej çdo qortimi sipas këndvështrimit të një vëzhguesi të arsyeshëm – në mënyrë që të ruajnë dhe forcojnë besimin e publikut dhe të rivendosin besimin në integritetin e gjyqësorit. Gjykata, gjithashtu, mori parasysh përfundimet e vendimeve të brendshme se kërkuesja nuk kishte zotëruar të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar gjendjen e likuiditeteve për disa vite, se ajo nuk kishte deklaruar origjinën e depozitave në llogaritë e huaja bankare dhe se bashkëjetuesi i saj, në kundërshtim me ligjin, nuk kishte deklaruar për disa vite një shumë të madhe parash që ai e mbante në gjendje « cash ».

Përsa i përket vlerësimit të aftësive profesionale, Gjykata vlerësoi se, duke u bazuar në rrethanat e çështjes aktuale, organet e vetingut nuk kishin dhënë arsye të mjaftueshme për të justifikuar përfundimin se ishte cenuar besimi i publikut në sistemin gjyqësor për shkak të mostërheqjes së kërkueses nga gjykimi kushtetues. Për më tepër, Gjykata theksoi se, për një vend të vogël si Shqipëria, nuk mund të kërkohej tërheqja automatike e një gjyqtari i cili kishte lidhje gjaku me një gjyqtar tjetër që kishte marrë pjesë në një gjykim tjetër në lidhje me një ose të gjitha palët e procesit. Pavarësisht këtij përfundimi, Gjykata çmoi se përfundimet e nxjerra në lidhje me vlerësimin e pasurive ishin mjaftueshmërisht të rënda sipas të drejtës së brendshme sa të justifikonin shkarkimin nga detyra të kërkueses.

Duke iu referuar përfundimeve të organeve të brendshme, Gjykata vlerësoi se shkarkimi nga detyra i kërkueses kishte qenë proporcional. Ekzistenca e një game të kufizuar të masave disiplinore në Ligjin e Vetingut ishte në pajtueshmëri me frymën e procedurave të vetingut, të cilat, duke qenë një proces unik, kishin si qëllim të pastronin sistemin e drejtësisë nga elementët e korruptuar dhe të ruanin pjesën e shëndetshme të tij. Për më tepër, ajo çmoi se ndalimi i përhershëm për të rihyrë në sistemin e drejtësisë për shkak të shkeljeve të rënda etike, i cili ishte vendosur nëpërmjet një ligji tjetër dhe gjente zbatim edhe ndaj kërkueses dhe personave të tjerë të shkarkuar nga detyra, kishte qenë i pajtueshëm me garantimin e integritetit të detyrës të magjistratit dhe të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Ky ndalim ishte akoma më i justifikuar për shkak të kontekstit kombëtar të një shteti të së drejtës në konsolidim e sipër.

Si rrjedhojë, nuk kishte patur shkelje të nenit 8 të Konventës.

Mendime pakice

Gjyqtarët Serghides dhe Dedov paraqitën secili një mendim pakice, të cilat gjenden në fund të vendimit.

Vendimi është hartuar vetëm në anglisht.

Njoftimi për shtyp, i cili është përgatitur nga Kancelaria, nuk ka fuqi detyruese për Gjykatën. Vendimet mbi pranueshmërisë dhe themelin, si dhe informacione të mëtejshme mbi Gjykatën, gjenden në faqen e internetit www.echr.coe.int. Nëse dëshironi të merrni njoftimet për shtyp të Gjykatës, luteni të abonoheni këtu: www.echr.coe.int/RSS/en ose të na ndiqni në Twitter [@ECHR_CEDH](https://twitter.com/ECHR_CEDH).

Kontaktet e shtypit

Për shkak të krizës aktuale të shëndetit publik, gazetarët mund të marrin kontakt me zyrën e shtypit përmes

echrpess@echr.coe.int

Neil Connolly

Tracey Turner-Tretz

Denis Lambert

Inci Ertekin

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u themelua më 1950, në Strasburg, nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës për të trajtuar pretendime për shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të vitit 1950.

[shqiptarja.com]